



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. 2427/26

Pejë, 27.08.2026

Në bazë të nenin 42, 47, 48, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rregullores për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në UHZ nr. 1165/22, të dt. 23.05.2022, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2026, pas shqyrtimit të propozimeve të njësive akademike, vendosi që të rishpall:

KONKURS

Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata në bazë të nevojave të njësive akademike të Fakultetit të Arteve në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, për vitin akademik 2026/27

Konkursi rishpallet sipas propozimeve të njësive akademike dhe atë si në vijim:

FAKULTETI I ARTEVE

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata:

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët për semestrin dimëror: Saksofon 5 (4+0), Pedagogji e instrumentit 2 (2+0), numri i orëve: 6; lëndët për semestrin veror: Saksofon 6 (4+0), numri i orëve: 4;
2. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët për semestrin dimëror: Solokëndim 3 (2+0), numri i orëve: 6; lëndët për semestrin veror: Solokëndim 4 (2+0), numri i orëve: 6;

I. Kushtet e përgjithshme dhe procedura për angazhim

1. Angazhimi me honorar i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime do të behët në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin NR. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 1165/22, të dt. 23.05.2022.
2. Procedura e angazhimit bëhet në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik sipas kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 1165/22, të dt. 23.05.2022.
3. Bashkëpunëtorët e jashtëm mund të angazhohen në UHZ për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve intelektuale për ligjërata dhe ushtrime mbi bazën e një konkursi publik, për pagesë me honorar. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.

4. UHZ nuk mund te angazhojë në ligjërata përkatësisht ushtrime asnjë bashkëpunëtor te jashtëm, i cili ka më tepër se një angazhim jashtë UHZ - së.

II. Kushtet e veçanta për angazhimin e bashkëpunëtorve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime

1. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata kandidatët duhet ti plotësojnë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë gradën shkencore Doktor i shkencave nga lëmia përkatëse (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të). Kandidatët të cilët krahas thirrjes Doktor i shkencave kanë edhe thirrje akademike të ligjëruesit ose profesorit, të fituar në një nga universitetet publike, kanë përparësi në përzgjedhje.
 - 1.2. Të ketë së paku 1 publikim në revistat shkencore ndërkombëtare (në Fakultetin e Arteve së paku 1 vepër artistike të rangut ndërkombëtar në fushën përkatëse) në përputhje me rregullën në fuqi për emërimin e personelit akademik.
2. Komisionet vlerësuese dhe këshillat e njësive akademike janë të obliguara që propozimet e tyre për pozitën e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të jenë në përputhje të plotë me [kodet e zonave të lëndëve të ERASMUS-it](#), në të kundërtën përgjegjësia bie mbi ta dhe propozimet nuk mund të pranohen nga Senati.

III. Fondi i orëve për bashkëpunëtorët e jashtëm

1. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata mund të mbajnë deri në 6 ore në javë.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë deri në 10 ore në javë.
3. Në raste të mungesës së bashkëpunëtorëve të jashtëm me gradën adekuate, në përputhje me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata në nivelin bachelor mund të angazhohen edhe kandidatët me gradën e Magjistratit (Mr. Sc.) ose Masterit (MA), nën mbikëqyrjen e profesorit me gradën Dr. Sc.
4. Paga për kategorinë nga paragrafi 3 i këtij neni bëhet si për bashkëpunëtorin për ushtrime.

IV. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - a) kërkesën me biografi;
 - b) certifikatën e lindjes (jo me te vjetër se 6 muaj);
 - c) kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar nga organi kompetent (kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë vendi, duhet të sjellin vendimin për nostrifikim-barasvlerën e diplomës përkatëse bachelor, master, magjistraturë, doktoratë);
 - d) kandidatët, të cilët konkurrojnë për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime, lektorit duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve bachelor dhe atyre master të noterizuara;
 - e) dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë;
 - f) dëshmitë për angazhimet paraprake në UHZ ose në ndonjë Institucion të akredituar të arsimit të lartë;

- g) dëshmia për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për konkurruesit.
- h) Dëshmi të organeve kompetente që nuk është nën hetime (jo më të vjetër se 6 muaj);
- i) Aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen fare.
- j) Kandidatët që kanë kontratë të rregullt të punës në Universitetet Publike në Kosovë dhe jashtë Kosovës më të cilat UHZ-ja, ka marrëveshje të bashkëpunimi për shkëmbim të personelit akademik dhe e cila është në fuqi ose kandidatët që kanë pasur angazhime edhe në të kaluarën dhe kanë dosjen në UHZ duhet të sjellin dokumentet si në vijim: **a)** Kërkesën me biografi (CV) duke specifikuar pozitën për të cilën aplikon dhe **b)** kopjen e vendimit për zgjedhjen e fundit që dëshmon thirrjen akademike pranë një institucioni publik të arsimit të lartë.

V. Kohëzgjatja e kontratës për honorar dhe kompensimi

1. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për angazhim me honorar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata më kohë të caktuar, varësisht prej fondit të orëve që posedojnë dhe kohëzgjatjes së angazhimit.
2. Kompensimi do të bëhet sipas raportit të orëve të realizuara, të nxjerra nga sistemi elektronik gjatë semestrit të caktuar, i cili vërtetohet nga njësia akademike përkatëse, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara sipas akteve të brendshme të UHZ - së.
3. Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me kohë të caktuar do të jenë të bazuara në dispozitat e Statutit UHZ - së, Ligjin NR. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës nr. 03-L-212, përkatësisht dispozitave të nenit 8, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.2, paragrafit 4, 7 dhe 8, nenit 11 dhe nenit 14 të këtij ligji.

VI. E drejta e ankesës

1. Fakultetet obligohen që të themelojnë komision për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësve lidhur me angazhimin e bashkëpunësorëve të jashtëm.
2. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese pranë komisionit për ankesa të njësive akademike përkatëse, brenda 4 ditëve nga dita e publikimit të vendimit të këshillit të fakultetit në web faqen e UHZ-së.
3. Komisioni i ankesave më së largu 3 dite pas përfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës të njëjtën ditë e dorëzon në këshill të fakultetit. Këshilli i fakultetit në afat prej 3 ditëve nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendosë për miratim ose refuzim të tij.
4. Ankesa duhet të jetë e qartë dhe konkrete, duhet të përfshijë të gjitha argumentet relevante dhe arsyeshmërinë e kontestimit të vendimit.
5. Shqyrtimi i ankesave dhe marrja e vendimit përkatës në këshillin e njësive akademike është vendim përfundimtar në nivel të Universitetit.

Vërejtje: Angazhimi në pozitat e lartshënuara do të bëhet varësisht nga plotësimi i vendeve të lartcekura më staf të rregullt akademik dhe numrin e grupeve të studentëve konform Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik. Kandidatët e përzgjedhur në raste të tilla ose në çfarëdo shtate tjetër që nuk mund të parashihet ose varët nga Universiteti, do të informohen më kohë lidhur me angazhimin apo mos angazhimin, para fillimit të çdo semestri.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen të skanuara në adresën elektronike: apliko.arte@unhz.eu, duke specifikuar saktë pozitën në të cilën aplikohet.

Aplikacionet e arritura pas afatit, ato të pakompletuara si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë ditë kalendarike) në <http://www.unhz.eu>, respektivisht prej datës 28.08.2026, deri me datën 04.09.2026.